



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5.5.2023

Nr: 450

Ora: 20:00

VENDIM

PËR

LIRIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE NË DISA KZAZ, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E

QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, janë kërkuar zëvendësime të anëtarëve në KZAZ-të si më poshtë vijon:

Partia Demokratike e Shqipërisë, me shkresën nr. 4484 prot., datë 02.05.2023, ka kërkuar lirim të dy (2) anëtarëve të KZAZ-së nr. 35, Bashkia Tiranë.

Partia Socialiste e Shqipërisë, me shkresën nr. 4688 prot., datë 05.05.2023, ka kërkuar lirim të anëtarit të KZAZ-së nr. 62, Bashkia Mallakastër.

Partia e Lirisë, me shkresën nr. 4706 prot., datë 05.05.2023, ka kërkuar lirim të anëtarit të KZAZ-së nr. 40, Bashkia Tiranë.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

Data: 5.5.2023 Nr: 450
Ora: 20:00



“Për lirim dhe emërimin e anëtarëve në disa KZAZ, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Lirimin nga detyra të anëtarëve në disa KZAZ, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Emërimin e anëtarëve në disa KZAZ, sipas lidhjes nr.2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Lidhja 1

Nr	Qarku	KZAZ	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti	Pozicioni
1	Tiranë	35	Elkond	Xhevahir	Allmeta	PD	Anëtar
2	Tiranë	35	Arsen	Dahut	Braho	PD	Anëtar
3	Tiranë	40	Alma	Shyqyri	Dyrmishi	PL	Anëtar
4	Fier	62	Laureta	Durim	Salaj	PS	Anëtar



Lidhja 2

Nr	Qarku	KZAZ	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti	Pozicioni
1	Tiranë	35	Vilson	Lirim	Rusi	PD	Anëtar
2	Tiranë	35	Daniela	Adriatik	Zoja	PD	Anëtar
3	Tiranë	40	Andi	Luigj	Toma	PL	Anëtar
4	Fier	62	Edlira	Zaçe	Muçi	PS	Anëtar

